



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.541/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hasan Shala kryesues, Fejzullah Rexhepi dhe Adnan Konushevci anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore Fitore Isufi, duke vendosur përkitazi me ankesat e anëtarit të kryesisë, Shaqir Ukshini, nga radhët e subjektit politik NISMA, me seli në Prishtinë, dega në Gjilan, për shkak të mungesës së votave, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 31.10.2017, mori këtë:

V E N D I M

HUDHEN si të palejuara ankesat ZL.A.nr.541/2017, ZL.A.nr.542/2017, ZL.A.nr.543/2017, ZL.A.nr.544/2017, ZL.A.nr.545/2017 dhe ZL.A.nr.546/2017 e anëtarit të kryesisë, Shaqir Ukshini, nga radhët e subjektit politik NISMA, me seli në Prishtinë, dega në Gjilan, të paraqitura, me datën 28.10.2017, për shkak të mungesës së votave, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017

A r s y e t i m

Me datën 28.10.2017, PZAP-i ka pranuar 6 (gjashtë) ankesa nga Shaqir Ukshini, anëtarë i kryesisë, nga radhët e subjektit politik NISMA, në emër të: Ardian Tahiri, Bajram Asllani, Fatmir Daku, Ekrem Tahiri, Albulena Sylaj dhe Armend Sherifi, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal Gjilan, me të cilat pretendon se ju mungojnë votat në Qendrat e Votimit, të Komunës së Gjilanit, si në: 0402x04R, 0403x03R, në Zhegër, 0409D/03R, 0409D/04R, 0409/03R, 0403D/01R, 0404D-05D, 0402D-07D, 0402D-01R, 0401x-01R dhe 0402x/05R.

Paneli, në bazë të nenit 8.3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, ka bashkuar ankesat e lartcekura dhe i trajton si një ankesë evidentuar me ZL.Anr.541/2017, për shkak të natyrës së njëjtë të rasteve dhe pretendimeve dhe për të dy ankesat i vendosi me një vendim për shkak të efikasitetit dhe ekonomizimit të procedurës .

Paneli, pasi që shqyrtoj paraprakisht lejueshmërinë e ankesave, gjeti se:

Ankesat janë të pa lejuara

Paneli nuk është lëshuar fare në vlerësimin e pretendimeve ankimore, lidhur me shkeljen e pretenduar, në ankesat e parashtruara përkitazi me manipulimin e votave në vendvotimet e cekura në ankesa, për faktin se shkeljet që ndërliken me rezultatin e votimit, nga shkelësi i supozuar, duhet të parashtrohen pas shpalljes së rezultatit përfundimtarë nga KQZ-ja, e jo në këtë fazë të procedurës. Në rastin konkret nga KQZ-ja, është marrë vendimi përfundimtar,

mbi shpalljen e rezultatit përfundimtar, andaj paneli vendosi që ti hudh si të parakohshme ankesat e ankuesit. Hudhja e ankesave të ankuesit nuk e paragjykon çështjen se ankuesit i mohohet e drejta që mbi këtë bazë, të paraqes ankesë tjetër, pas shpalljes së rezultatit përfundimtarë nga KQZ-ja.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lartë, e në kuptim të nenit 118 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

ZL. Anr.541/2017 më datën 31.10.2017.



Kryesuesi i Panelit
Hasan Shala

Këshillë juridike: *Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa.*